



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c), nenit 17 pika c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20, të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008. Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 29. 09. 2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT
15Nr.670-19941 E DATËS 29.05.2020**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i disa dispozitave të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 e datës 29.05.2020.

**Neni 2
Plotësimi dhe ndryshimi i dispozitave të Rregullores**

1.Me këtë Rregullore, ndryshohen dhe plotësohen: neni 1, neni 3 paragrafi 1, neni 4 , dhe neni 9 paragrafi 1 i Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670-19941 e datës 29.05.2020 dhe riformulohen si në vijim :

Neni 1-Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen, kushtet,kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës dhe procedura për ndarjen e bursave për studentë të cilët studiojnë në Universitetet dhe Kolegjet e Republikës së Kosovës.

Neni 3- Përfituesit e bursës

1. Të gjithë studentët, pa dallime etnike, gjinore, racore, fetare, sociale dhe politike, që janë të regjistruar në universitetet dhe kolegjet e Republikës së Kosovës, duke

përrjashtuar studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoraturë, kanë të drejtë të konkurojnë për marrjen e bursave për studime.

Neni 4 - Përfituesit e bursës me automatizëm

Fëmijët e Dëshmorëve që studiojnë në Universitetet dhe Kolegjet e Republikës së Kosovës, bursën e përfitojnë me automatizëm çdo herë kur Komuna shpallë thirrje publike për ndarjen e bursave për studentë dhe të njëjtit duhet të aplikojnë me dokumentacionin e kërkuar sipas thirrjes publike të shpallur nga Komuna.

Neni 9- Kriteret për përfitimin e bursës

1. Të gjithë studentët, pa dallime, që studiojnë në Universitetet dhe Kolegjet e Republikës së Kosovës e që kanë aplikuar për fitimin e bursës do të vlerësohen për sukseset e arritura në mësimet e studimeve të vitit paraprak me pikë si në vijim:

- 1.1. Studenti/ja me notë mesatare mbi 9 (nëntë), vlerësohet me 30 pikë,
- 1.2. Studenti/ja me notë mesatare mbi 8 (tetë), vlerësohet me 20 pikë,
- 1.3. Studenti/ja me notë mesatare mbi 7 (shtatë), vlerësohet me 15 pikë,
- 1.4. Studenti/ja me notë mesatare mbi 6 (gjashtë), vlerësohet me 5 pikë,
- 1.5. Studenti/ja me nevoja të veqanta vlerësohet me 10 pikë,
- 1.6. Studenti/ja me asistencë sociale vlerësohet me 10 pikë,
- 1.7. Studenti/ja me studime në drejtimet deficitare vlerësohet me 10 pikë (drejtimeve deficitare që mundë t'i jepet përparësi përcaktohen në thirrjen publike për aplikim nga Drejtorati për Arsim),
- 1.8. Studenti/ja fëmijë i martirëve, veteranëve, invalidëve vlerësohet me 10 pikë,
- 1.9. Studenti/ja që studion së bashku me një anëtar nga familja e ngushtë vlerësohet me 10 pikë,
- 1.10. Studenti/ja që nuk i ka dy prindërit në jetë vlerësohet me 10 pikë.
- 1.11. Studenti/ja që i përket komunitetit jo shumicë vlerësohen me 10 pikë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare elektronike të Komunës.

15 Nr. 670-47372

Lipjan, më 30. 09. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

